SPECIFIKIMET TEKNIKE

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A

"Platforma për menaxhimin e shit-blerjes së energjisë si dhe modulet mbështetëse"

1 FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

1.1 Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet

2 NËNSHKRIMET MIRATUESE

Përgatiti:

Përgatiti:

Përgatiti:

Pergatiti:

Miratoi:

Miratoi:

3 PËRMBAJTJA

4 Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a), është një shoqëri tregtare aksionere shtetërore dhe është prodhuesi kryesor dhe më i rëndësishëm i energjisë elektrike në Shqipëri, që administron dhe operon hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (HEC-Fierzë, HEC-Koman, HEC-Vau i Dejës).

4.1 Hyrje

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a e zhvillon aktivitetin e saj duke administruar dhe operuar hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (tre njësive të prodhimit HEC-Fierzë, HEC-Koman, HEC-Vau i Dejës) të cilët kanë rëndësisë së veçantë për ekonominë e vendit) dhe personelit në zyrat e administratës qendrore, Blloku Vasil Shanto Tiranë.

Misioni kryesor i KESH sh.a është plotësimi i kërkesës së vendit për energji elektrike me kosto sa më të ulet duke shfrytëzuar me efektivitet burimet ujore ekzistuese dhe duke zhvilluar burime të reja. Gjithashtu monitorimi dhe garantimi i jetëgjatësisë dhe sigurisë së veprave nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe efektiv të tyre, mirembajtjes dhe modernizimit të sistemeve të monitorimit është një sfidë që KESH sh.a. ka ndërmarrë veçanërisht vitet e fundit.

5 Përshkrimi i Përgjithshëm i kërkesave

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi i nje sistemi i cili do te beje te mundur publikimin e tenderave te shitjes dhe blerjes se energjise elektrike nga ana e KESH, ku me pas te gjithe operatoret vendas apo te huaj te cilet deshirojne te japin ofertat e tyre per keto tender ate kene mundesine te ofertojne online ne kete sistem. Sistemi gjithashtu do te beje te mundur sugjerimin ne menyre automatike te ofertave me te favorshme per KESH per te maksimizuar te ardhurat dhe per te ulur shpenzimet. Ne kushtet ku KESH sh.a. eshte pajisur me license ne aktivitetin e furnizimit me energji elektrike si dhe ku parashikohet qe procedurat e shit-blerjes se energjise elektrike do te kryhen me mjete elektronike/platforme, linde nevoja per hartimin e rregulla te reja te tregtimit te energjise elektrike.

5.1 Kërkesat funksionale të sistemit (modulet)

5.1.1 Moduli i krijimit të përdoruesve

Në këtë modul sistemi duhet ti japë mundësi administratorit të krijojë përdorues të tjerë në sistem. Gjatë krijimit të përdoruesve duhen plotësuar saktë fushat Emër, Mbiemër, roli i përdoruesit në sistem, email, numër telefoni dhe password. Në çastin e krijimit të përdoruesit sistemi duhet të dërgojë në adresën e email të regjistruar për këtë përdorues një lidhje për të verifikuar llogarinë. Nëse përdoruesi nuk e klikon linkun e dërguar në email atëherë ai nuk mund të kyçet në sistem. Pasi përdoruesi klikon linkun dhe verifikon llogarinë atëherë ai mund të kyçet në sistem. Sistemi duhet të detektojë nëse ky përdorues po kyçet për herë të parë apo jo. Nëse përdoruesi po kyçet për herë të parë atëherë sistemi duhet ti kërkojë përdoruesit të aktivizojë opsionin e kyçjes me dy hapa (two step authentication) në të cilin

përdoruesit duhet ti kërkohet te skanojë me anë të një aplikacioni për autentikim një kod QR i cili duhet të gjenerojë fjalëkalime njëperdorimshme. Pasi përdoruesi ka aktivizuar opsionin e kyçjes me dy hapa dhe ka vendosur kodin e saktë atëherë ai do mund të kyçet në sistem. Sistemi nuk duhet të lejojë kyçjen pa aktivizimin e këtij opsioni për efekt të rritjes .

5.1.2 Moduli i krijimit te klienteve

Ne kete sistem klient do te quhet cdo operator vendas apo i huaj i cili eshte i interesuar te marre pjese ne prokurimet e publikuara nga KESH per shitblerjen e energjise elektirike. Pershkak te rendesise se sistemit klientet e interesuar duhet ne fillim te kontakojne me KESH, i cili ben verifikimin e dokumentave dhe me pas perdoruesit e brendshem te kesh kane mundesi te krijojne llogari klienti per ta. Per te krijuar nje klient perdroeusit e KESH regjistrojne emrin e klientit, shtetin, aksioneret, ngarkojne dokumentat perkatese, vendosin te dhenat per perdoruesin i cili do te futet ne sistem. Ne castin e krijimit te klientit paralelisht ne menyre automatike sistemi duhet te krijoje dhe perdoruesin peraktes per ate klient. Pas krijimit te perdoruesit sistemi duhet te mundesoje te njejten rrjedhe per kycjen e perdoruesit ne sistem si ne piken 1.

5.1.3 Moduli i garancise bankare

Ne kete modul perdoruesit e finances kane mundesine te ngarkojne ne sistem nje dokument I cili verteton garancine bankare te mbyllur nga nje klient ne benefit te KESH. Sistemi duhet ti mundesoje perdoruseve mundesine e ngarkimit te ketij dokumenti si dhe ti japi mundesine atyre qe te plotesojne fushat si, vlera totale e garancise, daten e skadimid, vlera e mbetur qe mbulon garancia. Kur nje klient shpallet fitues per nje tender dhe ai nuk I ka derguar KESH-it veretitmin e pageses keshi mund te perdore garancine bankare per te proceduar me dergimin e energjise. Per ta bere kete gje nevojitet qe vlera e mbetur e garancise bankare te jete me e madhe se sa vlera qe klienti I detyrohet KESH. Ne castin qe klienti I dergon KESH vertetimin e pageses per tendering perkates dhe KESH ka perdorur garancine bankare te klientit, atehere velra e pageses I shtohet vleres se garancise bankare per klientin.

5.1.4 Moduli i kapaciteteve nderkufitare

Ne kete modul perdoruesit e kesh duhet te kene mundesine qe te regjistrojne ne sistem te gjith blerjet qe kesh ben per blerjet e kapaciteteve nderkufitare. Ne kete modul regjistrohen te dhenat se kur eshte bler nje kapacitet nderkufitar, drejtimin, kapacitetin e blere (MW), daten e blerjes, dhe vleren me te cilen eshte blere ky kapacitet. Ky informacion do te perdoret ne modulin e prokurimit ne te cilin KESH do te percaktoje nese per nje tender specifik kapaciteti nderkufitar sigurohet nga KESH apo eshte pergjegjesi e klientit.

5.1.5 Moduli i publikimit te tenderave

Ne kete modul perdoruesit e KESH do te kene mundesine te publikojne nje tender per shitje apo per blerje energjie. Ne kete modul perdoruesit do te kene mundesine te hedhin informacion lidhur me nje tender te caktuar. Informacioni perfshin nje emertim dhe pershkrim te tenderit, daten kur fillon pranimi I ofertave dhe daten kur mbaron pranimi I ofertave, daten kur fillon dhe kur mbaron shitblerja e energjise, kapacitetin qe do bliehet apo shitet si dhe informacion lidhur me kapacitetin nderkufitar. Per cdo tender perdoruesit e

KESH do te kene mundesi te krijojne profilet orare (ose lotet) ne te cilet do te specifikohen sakte fashat orare kur KESH deshiron te shese dhe te bleje energji. Cdo tender qendron fillimisht ne statusn DRAFT dhe publikohet manualisht nga administratori I sistemit.

5.1.6 Moduli i dorezimit te ofertave

Ne kete modul klientet kane mundesi te japin ofertat e tyre per cdo tender. Klientet jane te detyruar qe oferten ta bejne per cdo profil (lot). Oferta e bere nga klienti mund te mos jete per te gjithe kapacitetin e kerkuar nga KESH ose mund ta tejkaloje kapacitetin qe KESH kerkon. Nje klient ka te drejte te modifikoje oferten e tij deri kur afati i dorezimit te ofertave te kete perfunduar. Pas perfundimit te afatit te dorezimit te ofertave sistemi nuk lejon me modifikimin e ofertes nga klienti. Per cdo oferte te derguar sistemi njofton me SMS klientin qe oferta e tij u dorezua me sukses.

5.1.7 Moduli i vleresimit te ofertave

Ne kete modul sistemi i jep mundesine perodruesve te KESH te vleresojne ofertat e dhena nga klientet per nje tender te caktuar. Keto oferta mund te behen te dukshme nga KESH vetem pasi afati i dorezimit te ofertave ka perfunduar. Sistemi gjithashtu do te beje te mundur sugjerimin ne menyre automatike te ofertave me te favorshme per te maksimizuar te ardhurat dhe per te ulur shpenzimet. KESH ka mundesine te perzgjedhe si fitues Kliente te ndryshem per cdo profil (lot). KESH ka mundesine te perzgjedhe ne menyre parciale nje oferte per nje lot te caktuar (pra te marri vetem nje pjese te ofertes se dhene nga nje klient) dhe jo te gjithe oferten per cdo lot. Pas perzgjedhjes si fituese te nje oferte per lot KESH ka te drejte te shpalle fituesit zyrtarisht.

5.1.8 Moduli i gjurmëve (log) dhe sigurisë së modulit të portalit

Aplikacioni duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori (përdoruesi), rekordi i ndryshuar, fushat e ndryshuara për çdo rekord, vlerat para modifikimit dhe ajo pas modifikimit, IP, sesioni etj. Gjurmët e auditimit duhet të jenë të aksesueshme por të pa modifikueshme nga ndërfaqja e sistemit. Të ofrohet mundësia që të krijohen rregulla auditimi në bazë të ambienteve dhe përdoruesve. Të përcaktohen veprimet që duhet të auditohen si lexim, modifikim, krijim, fshirje, rrjedhë pune. Komunikimi me databazën duhet të jetë i sigurtë dhe çdo rekord që ruhet të jetë i enkriptuar bazuar në një algoritëm të fortë enkriptimi. Kanali i lidhjes midis shfletuesit (browser-it) dhe Server Qendror duhet të jetë e sigurtë dhe i enkriptuar me TSL/SSL nëpërmjet protokollit HTTPS. Sistemi duhe të gjenerojë loget e sigurisë në një format raporti apo file i lexueshëm nga administratori kryesor i sistemit. Rekordet duhet të duplikohen dhe në një databazë të jashtme auditi. Kodi dhe modulet e sistemit duhet që të sigurojnë një versionim dhe historik të ndryshimeve që do të bëhen në sistem. Aksesi në sistem duhet të realizohet nga përdoruesit e jashtëm apo të brendshëm përmes autentikimit me dy faktorë: username/password dhe token. Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e monitorimit të aksesit në sistem përmes logeve. Moduli i portalit duhet të suportojë përdorimin e token mobile për iOS apo Android për përdoruesit e jashtëm.

6 Specifikime teknike të sistemit

Sistemi duhet të funksionojë bazuar në mikroservise si dhe të ketë dy nën projekte: ***front end*** dhe ***back end.***

6.1 Frontend

Frontend duhet te suportoje standartet web te programimit CSS 3, HTML 5, dhe te jete kompatibel me te gjithe shfletuesit (browsers). Front end duhet te jete ne gjendje te marre te dhena nga backend duke konsumuar webserviset REST. Duhet te jete ne gjendje te menaxhoje tokenat e sigurise si dhe te menaxhoje refresh token per cdo perdorues. Sistemi front-end duhet te ndertoje funksionalitetet e tij si komponente te cilet te kene mundesi te riperdoren ne cdo modul te sistemit. Sistemi frontend duhet te ndertohet i tille qe te jete totalisht i pavarur nga backend dhe te jete funksional pa qen nevoja e nderhyrjeve te metejshme nese teknologjia e sistemit backend ndryshon. Sistemi duhet ti shfaqe qarte perdoruesve erroret dhe mesazhet e suksesit. Frontend duhet gjithashtu te suportoje javascript.

6.2 Backend

Backend duhet te ndertohet ne nje gjuhe programimi e cila suporton arkitekturen MVC. Te gjithe modulet e sistemit duhet te konceptohen si mikroservise dhe te dergojne te dhena tek Frontend nepermjet web-serviseve REST. Backend duhet te mbroje web-serviset REST nga perdorimi i pautorizuar duke kerkuar nje security token per cdo te dhene qe eshte sensitive. Backend duhet te suportoje nderveprimin me databazat RDBS. Backend duhet te jete ne gjendje te prodhoje dokumentacionin e nevojshem per konsumimin e web-serviseve qe nevojiten per funksionimin e sistemit.

6.3 Databaza

Databaza duhet te jete e llojit RDBS dhe te jete kompatibel me teknologjine qe do te perdoret per sistemin e backend. Duhet te jete ne gjendje te ruaje logs per te gjithe veprimet qe ndodhin ne databaze si dhe te gjithe query-t qe ekzekutohen ne te.

6.4 Arkitektura

Sistemi duhet te hostohet ne nje arkitekture e cila suporton auto scaling (rritjen automatike te kapaciteteve bazuar ne nevojat e sistemit). Autoscaling duhet te ndodhe ne menyre automatike pa qene nevoja e nderhyrjes manuale. Databaza duhet te jete e replikuar te pakten ne nje lokacion tjeter pervec lokacionit primar, dhe te garantoje sigurine dhe konsistencen e te dhenave ne cdo kohe. Infrastruktura e rrjetit ne te cilen do te hostohet aplikacioni duhet te beje te mundur aksesimin e databazes vetem nga serveri ku do te ruhet sistemi i backend. Aksesi i databazes nuk duhet te jete i mundur pa kriteret e sigurise.

Infrastrkutura duhet gjithashtu te suportoje adaptimin automatik. Cdo modul i ri apo permiresim qe kryhet ne sistem duhet te kete mundesine te behet adaptim ne menyre automatike nga infrastruktura pasi eshte bere bashkimin me kodin burim aktual.

Arkitektura duhet te jete ne gjendje te mbroje sistemin nga sulmet nga jasht si dhe sulmet DDoS, dhe te pershtatet me standartet dhe te dhenat e sigurise kibernetike.

6.5 Kodi burim

Kodi burimi nderfaqes dhe jo praktikave apo te dhenave, duhet te ruhet ne platformen git (Gitlab, Github ose ekuivalente). Kodi burim duhet te kete dy ndarje kryesore, main dhe development. Ku main do te perdoret per te mbajtur kodin i cili eshte ne sistemin live dhe development do te perdoret per te mbajtur kodin i cili eshte ne sistemin test. Teknologjia git duhet te beje te mundur qe gjate hedhjes se funksionaliteteve te reja ne kodin burim te beje kontrollet e nevojshme dhe teste automatike te kodit burim per te garantuar funksionalitetin e sakte te sistemit. Cdo funksionalitet i sistemit duhet te ndertohet ne nje dege(branch) te vecante dhe te jete kollaj I kthyeshem nese ndonje ndonje problematike e cila pengon funksionalitetin e sistemit.

6.6 Ndërveprimi me sistemet e tjera

Sistemi duhet te jete ne gjendje te ndervepoje me sistemet e tjera si: Dogana, Tatimet apo sistemet bankare. Integrimi me sistemin e doganes duhet te behet ne castin e blerjes se energjise elektrike. Integrimi me sistemin e tatimeve duhet te behet per deklarimin e faturave ne sistemin e fiskalizimit ndersa integrimi me sistemet bankare duhet te kryhet per te bere te mundur vertetimin automatik te pagesave. Keto integrime do te zhvillohen sipas kerkesave te KESH sh.a. ne diskutim me stafin e operatorit ekonomik qe do te zhvilloje projektin.

6.7 Proceset e biznesit (Workflows) që platforma duhet të ndjekë në funksionimin në tërësi të saj.

6.7.1 Aplikimi për regjistrimin e shoqërive tregtare

- Aplikimi bëhet me komunikim zyrtar me KESH sh.a.
- Aplikantët plotësojnë formën e aplikimit.
- Upload dokumentat për regjistrim
    - Kërkesa e shoqërisë për rregjistrim;
    - Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtar gjyqësor të shtetit përkatës në të cilin shoqëria është regjistruar.
    - Licencen për tregtimin/furnizimin e energjisë elektrike të lëshuar nga autoritete përgjegjëse.
    - Dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës të cilët vërtetojnë se:
        - Subjekti i licencuar nuk është ne proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;
        - Subjekti i licencuar dhe administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen penalisht për shkelje penale për çeshtje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);
        - Subjekti i licencuar ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në përputhje me legjislacionin e shtetit përkatës

        - Pasqyrat financiare të subjektit të licencuar , të vitit të fundit, të çertifikuara sipas rregullave të shtetit përkatës ku shoqëria ushtron aktivitetin.
- Stafi i KESH i cili meret me operimet tregtare, zbaton procedurat e brendeshme per krijim e përdoruesit në sistem
- Sistemi dërgon njoftimet përkatëse sipas procedurave, nëpërmjet platformës në adresat elektronike të regjistruara të subjektit.
- Aprovimi i regjistrimit sipas kritereve, referuar udhëzimeve ligjore duke e shoqëruar me dërgimin e kontratës tip.
- Aprovimi/mosaprovimi i regjistrimit shoqërohet me ruatjen e komenteve dhe dokumentave bashkëngjitur.
- Aprovimi i regjistrimit shoqërohet me krijimin e llogarive në sistem.

Dokumentacioni i mësipërm duhet përditësuar nga shoqeritë sipas kërkesës së shoqërisë KESH sh.a., bazuar në rregullat e tregtimit të energjisë elektrike nga KESH SH.A.
Sistemi elektronik duhet të mundësojë gjenerimin e njoftim të marrjes së aplikimit ose jo të shoqërive të interesuara që kërkojnë të rregjistrohen në procedurat e shit-blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a. sipas nevojës së stafit menaxhues të sistemit. Në rast të mos marrjes së aplikimit, dhe evidentimit të zërave që nuk janë plotësuar sipas kërkesës për rregjitrim (kjo me qëllim që shoqëria e interesuar të riplotesojë zërin për të cilën sistemi elektronik i ka kthyer mbrapsh kerkesen per rregjistirm).

6.7.2 Administrimi i kalendarit të kërkesave/ftesave për shitje/blerje

- Ndërtimi i kalendarit sipas kërkesave/ofertës për shitje (ask)/blerje (request for bid).
- Krijimi i kategorisë së procedurës shitje/blerje.
- Përcaktimi i vlefshmërisë së kërkesë/ofertës sipas periudhave, fashave orare.
- Përcaktimi i lote-ve së kërkesë/ofertës sipas periudhave, fashave orare:
    - kapaciteteve shit/blerje
    - sasive shit/blerje
    - çmimeve të shit/blerjeve
    - pikave të lëvrimit të shit/blerjes
- Vlerësimi i kërkesë/ofertës dhe menaxhimi i procedurës në të gjithë fazat e saj.
- Mirëmbajtja e kalendarit , përditësimi i tij.
- Mbledhja dhe shqyrtimi i kuotimeve për shitje/blerje.
- Formati i kërkesave për shitje/blerje.
- Publikimi i informacioneve zyrtare, i gjithë informacionit mbi procesin e shitjes/blerjes së energjisë elektrike.
- Rikonfirmimi i dokumentave ligjore dhe administrative për çdo procedurë/ kërkesë për shitje/blerje që publikohet rishtas.
- Mundësi listimi përzgjedhje të ofertave për shitje/blerje mbi bazën e kritereve të vlerësimit sipas nevojave të stafit të operimit.
- Komunikimi dhe ndërveprimi i operatorit KESH me pjesëmarrësit nëpërmjet platformës.
- Menaxhimi i procedurave të shitjes/blerjes.
- Njoftimi i fituesit dhe raportimi i informacionit.

- Dashboard administrativ i cili duhet të përbledhë aktivitet historik të transaksioneve dhe mundësia për shfaqe interaktive.

6.7.3 Administrim i ankesave

a. Hartimi i ankesave referuar kalendarit të kërkesave për shitje/blerje/shitje .
b. Përsëritja e procesit të dërgimit të kërkesës.
c. Publikimi ankesave në sistem dhe transparenca për tregtarët pjesëmarrës.

6.8 Proceset e biznesit (Workflows) te tregtimit te energjise elektrike të detajuara

Me poshtë po paraqesim proceset e tregtimit të energjisë elektrike të detajuara sipas rasteve:

Per shitje te energjise elektrike. Kerkesa/ftesa per oferte duhet te permbaje:

- Periudha/dita e shitjes se energjise elektrike e cila mund te jete:
  - Periudhe ne blloke;
  - Periudhe e kushtezuar (psh. Shitje energji elektrike 1-30 Prill 2019, por periudhen 1-10 Prill eshte e konfirmuar,ndersa periudhat 11-20 dhe 21-30 Prill do rikonfirmohen respketivisht ne datat 8 dhe 18 Prill 2019);
  - Peridhe me dite te ndara;

- Profili i levrimit te energjise elektrike nga ora 00: 00deri me 24:00 e cila mund te jete:
  - Profile ne blloke;
  - Profile me ore te ndara;

- Kapaciteti i shitjes se energjise elektrike e cila mund te jete:
  - Kapacitetin maksimal i kerkuar per tu ofertuar/deri ne... MW;
  - Kapacitet i kushtezuar (Psh: shitje energji elektrike per periudhen 11-20 Prill 2019 ne kapacitetin 50 MW,por KESH sh.a. i rezervon te drejten vetes qe me date 8 Prill 2019 ku do te konfirmoje periudhen e shitjes te zgjidhe edhe kapacitetin e levrimit e cila mund te jete nga 0 MW deri me 50 MW)
  - Kapacitet ne blloke;
  - Kapacitet me ore te ndara;

- Sasia e energjise elektrike mund te jete:
  - Sasia maksimale e kerkuar per tu ofertuar/ deri ne .... MWh;
  - Sasia e kushtezuar (Psh: shitje energji elektrike per periudhen 11-20 Prill 2019 ne kapacitetin 50 MW dhe sasine 1200 MWh, por KESH sh.a. i rezervon te drejten vetes qe me date 8 Prill 2019 ku do te konfirmoje periudhen e shitjes te zgjidhe edhe kapacitetin e levrimit e cila mund te jete nga 0 MW deri me 50 MW respektivisht edhe sasia e energjise elektrike)
  - Sasia ne blloke;
  - Sasi me ore te ndara;

- Cmimi njesi i kerkuar per tu ofertuar mund te jete:
  - Cmime/njesi ne blloke;
  - Cmime/njesi orar;

- Cmime/njesi dysheme;

➢ Pika e levrimit te energjise elektrike e cil mund te jete:
- Brenda rrjetit te transmetimit
- Ne kufirin Shqiperi-Mali i Zi/Serbi/Greqi

➢ Siguruesi i kapacitetit mund te jete:
- Nga shoqerite ofertuese;
- Nga KESH sh.a.;

➢ Kriteri vleresimit te ofertave eshte:
- cmimi/njesi me i larte deri ne permbushjen e sasise se kerkuar per shitje te energjise elektrike;
- i kushtezuar sipas cmimit dysheme tevendosur ne oferte;
- Ne rast kur kemi dy oferta me te njejtin cmimi do te ndiqet parimi i pari qe vjen i pari sherbehet/pranohet;

➢ Kriteri financiar lidhur me menyren e pageses mund te jete:
- Me parapagim;
- Garanci financiare;
- Mjete te jera financiare;

➢ Afati i hapjes dhe e mbylljes se mjetit elektronik te perdoruar nga KESH sh.a. per zhvillimin e procedures se shit-blerjes se energjise elektrike per ofertimin e shoqerive tregtare;

➢ Kushte te tjera te vendosura nga Autoriteti Kontraktues;

➢ Raporti i mbylljes se procedures/rezultatet e procedures se shitjes duke publikuar cmimet dhe sasite mesatare te ofertuara dhe ato te fituara.

➢ Ankimimi. Brenda afatit te percaktuar ne kerkesen/ftesen per oferte shoqerite kane te drejte qe nepermjet sistemit elektronik te dergojne ankesen dhe sipas afateve te percaktuara do ti kthehet pergjigje, duke mos penguar aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike.

<u>Per blerje te energjise elektrike. Kerkesa/ftesa per oferte duhet te permbaje:</u>

➢ Periudha/dita e blerjes se energjise elektrike e cila mund te jete:
- Periudhe ne blloke;
- Periudhe e kushtezuar (psh. Blerje energji elektrike 1-30 Prill 2019, por periudhen 1-10 Prill eshte e konfirmuar,ndersa periudhat 11-20 dhe 21-30 Prill do rikonfirmohen respketivisht ne datat 8 dhe 18 Prill 2019);
- Peridhe me dite te ndara;

➢ Profili i marrjesse energjise elektrike nga ora 00:oo deri me 24:oo e cila mund te jete:
- Profile ne blloke;
- Profile me ore te ndara;

➢ Kapaciteti i blerjes se energjise elektrike e cila mund te jete:
- Kapacitetin maksimal i kerkuar per tu ofertuar/deri ne... MW;

- Kapacitet i kushtezuar (Psh: blerje energji elektrike per periudhen 11-20 Prill 2019 ne kapacitetin 50 MW,por KESH sh.a. i rezervon te drejten vetes qe me date 8 Prill 2019 ku do te konfirmoje periudhen e blerjes te zgjidhe edhe kapacitetin e levrimit e cila mund te jete nga 0 MW deri me 50 MW)
- Kapacitet ne blloke;
- Kapacitet me ore te ndara;

➢ Sasia e energjise elektrike mund te jete:
- Sasia maksimale e kerkuar per tu blere/ deri ne .... MWh;
- Sasia e kushtezuar (Psh: blerje energji elektrike per periudhen 11-20 Prill 2019 ne kapacitetin 50 MW dhe sasine 1200 MWh, por KESH sh.a. i rezervon te drejten vetes qe me date 8 Prill 2019 ku do te konfirmoje periudhen e blerjes te zgjidhe edhe kapacitetin e levrimit e cila mund te jete nga 0 MW deri me 50 MW respektivisht edhe sasia e energjise elektrike)
- Sasia ne blloke;
- Sasi me ore te ndara;

➢ Cmimi njesi i kerkuar per tu ofertuar mund te jete:
- Cmime/njesi ne blloke;
- Cmime/njesi orar;
- Cmime/njesi tavan;

➢ Pika e levrimit te energjise elektrike e cil mund te jete:
- Brenda rrjetit te transmetimit
- Ne kufirin Shqiperi-Mali i Zi/Serbi/Greqi

➢ Siguruesi i kapacitetit mund te jete:
- Nga shoqerite ofertuese;
- Nga KESH sh.a.;

➢ Kriteri vleresimit te ofertave eshte:
- cmimi/njesi me i ulet deri ne permbushjen e sasise se kerkuar per blerje te energjise elektrike;
- i kushtezuar sipas cmimit tavan te vendosur ne oferte;
- Ne rast kur kemi dy oferta me te njejtin cmimi do te ndiqet parimi i pari qe vjen i pari sherbehet/pranohet;

➢ Kriteri financiar lidhur me menyren e pageses mund te jete:
- Me parapagim;
- Garanci financiare;
- Mjete te jera financiare;

➢ Afati i hapjes dhe e mbylljes se mjetit elektronik te perdoruar nga KESH sh.a. per zhvillimin e procedures se shit-blerjes se energjise elektrike per ofertimin e shoqerive tregtare;

➢ Kushte te tjera te vendosura nga Autoriteti Kontraktues;

➢ Raporti i mbylljes se procedures/rezultatet e procedures se sblerjes duke publikuar cmimet dhe sasite mesatare te ofertuara dhe ato te fituara.

➢ Ankimimi. Brenda afatit te percaktuar ne kerkesen/ftesen per oferte shoqerite kane te drejte qe nepermjet sistemit elektronik te dergojne ankesen dhe sipas afateve te percaktuara do ti kthehet pergjigje, duke mos penguar aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike.

6.9 Siguria e sistemit

Pajisja e monitorimit të zgjidhjes duhet të jetë në gjendje të mbështesë mënyrat e mëposhtme të vendosjes për të monitoruar trafikun e aplikacioneve në ueb në rrjet:
- Nëpërmjet një modaliteti nuhatës të portit SPAN/TAP
- Modaliteti i urës së brendshme transparente të shtresës 2 (duhet të jetë mbështetje vendase dhe jo përmes integrimit të palës së tretë)
- Modaliteti i përfaqësuesit të kundërt
- Modaliteti Transparent Layer-2 Reverse Proxy (Layer-2, por që përfundon sesionet përkatëse TCP)

Për modalitetin e vendosjes së urës së brendshme të shtresës 2 dhe për pajisjet fizike, zgjidhja duhet të ketë një anashkalim të integruar për të mbështetur modalitetin "hapja e dështuar". Zgjidhja duhet të ketë gjithashtu aftësinë për të mbështetur modalitetin "fail-close". Kjo duhet të jetë një veçori e mbështetur në mënyrë origjinale në zgjidhje dhe jo nëpërmjet një integrimi të palës së tretë.
E gjithë zgjidhja duhet të menaxhohet nga qendra për operacionet e përditshme. Raportimi, krijimi i politikave, menaxhimi i sinjalizimeve, konfigurimi i mbrojtjes së aplikacionit në ueb, etj duhet të menaxhohen nga serveri i menaxhimit. Serveri i menaxhimit duhet të menaxhojë në mënyrë qendrore të gjitha portat e ndryshme të monitorimit. Zgjidhja duhet t'i lejojë përdoruesit të përdorë një shfletues standard për të hyrë në ndërfaqen e menaxhimit.
Gjatë shkallëzimit të zgjidhjes, zgjidhja duhet të mbështesë një qasje të zmadhuar duke u mjaftuar vetëm të shtojë më shumë porta monitorimi sipas nevojës dhe të regjistrojë portat në serverin e menaxhimit.
Zgjidhja duhet të mbështesë një model vendosjeje të shpërndarë WAN/global, ku mund të vendosen shumë Serverë Menaxhimi për çdo rajon gjeografik. Të gjithë serverët e menaxhimit duhet të jenë në gjendje të menaxhohen në mënyrë qendrore nga një "Menaxheri i Menaxherëve". "Menaxheri i Menaxherëve" duhet të ofrojë aftësitë e mëposhtme:
- Menaxhimi dhe administrimi i unifikuar i mjediseve të federuara në të gjithë serverët e menaxhimit
- Krijimi, konfigurimi dhe shpërndarja e politikave në të gjithë sistemin në të gjithë serverët e menaxhimit
- Pika e vetme e aksesit në çdo Server Menaxhimi
- Monitorimi i shëndetit të zgjidhjes për të gjithë vendosjen
- Pamje e gjerë e sistemit të aktiviteteve të sigurisë

Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të mbështesë rastin e përdorimit ku disa aplikacione ueb mbrohen në modalitetin Transparent Reverse Proxy dhe disa aplikacione ueb për t'u mbrojtur në modalitetin e urës së brendshme transparente Later-2. Kjo duhet të mbështetet në mënyrë origjinale në zgjidhje dhe jo nëpërmjet integrimit të zgjidhjeve të tjera nga palët e treta. Përshkruani se si arrihet kjo.
Zgjidhja duhet të jetë e thjeshtë dhe intuitive për t'u konfiguruar dhe konfiguruar. Me të gjitha miratimet e kërkuara të menaxhimit të ndryshimeve në vend dhe informacionin e rrjetit në dispozicion.

